



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA FINIQ
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE**

Nr. _____ Prot

Finiq me, / / 2026

Lënda : Dërgohet shpallje për publikim

Drejtimi : Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

T I R A N Ë

Përshëndetje dhe punë të mbarë !

Bashkëlidhur po ju dërgojmë shpalljen për publikim në portalin tuaj, shpallje pozicioni për lëvizje paralele, dhe pranimin në Shërbimit Civil, kategoria ekzekutive për pozicionin:

- *Përgjegjës i Njesisë së Prokurimeve Publike pranë Drejtorisë juridike – kat. III-2;*

Nga ana jonë është dërguar dhe në mënyrë elektronike në adresën tuaj”
vendetelirapune@akpa.gov.al.

Për çdo paqartësi na komunikoni në adresën Irena.Exsarho@bfiniq.gov.al , ose numër kontakti 0694793927.

Ju faleminderit për mirëkuptimin !

KRYETARI

Romeo ÇAKULI

Konceptoi: S.Kallojeri

Pranoi: I.Eksarho



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIAFINIQ
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE**

Data 24.04.2026

**SHPLLJE PËR NËPUNËS CIVIL LËVIZJE PARALELE , NGRITJE NË
DETYRË DHE PRANIM EDHE PËR KANDIDATË NGA JASHTË
SHËRBIMIT CIVIL**

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, *Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Finiq* shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë edhe për kandidatë nga jashtë shërbimit civil për pozicionin:

- *Përgjegjës i Njësisë së Prokurimeve Publike pranë Drejtorisë juridike – kat. III-2;*

Pozicioni më sipër u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit edhe për kandidatë nga jashtë shërbimit civil.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranim edhe për kandidatë nga jashtë shërbimit civil) aplikohet në të njëjtën kohë!.

Afati për dorëzimin e dokumentave për

LËVIZJE PARALELE:

04 Maj 2026

Afati për dorëzimin e dokumentave për

PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL:

08 Maj 2026

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin më sipër është:

- Përbush të gjitha detyrat që i ngarkohen nga Drejtori, në zbatim të legjislacionit në fuqi.
- Relaton pranë Drejtorit në mënyrë periodike për përrmbushjen e detyrave të përcaktuara.

- Mban përgjegjësi për për zgjedhjen e procedurës, vendosjen e afateve dhe respektimin e tyre duke ju referuar në çdo hap legjislacionit në fuqi.
- Është përgjegjës për hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për botim, brënda afateve kohore, për hartimin e urdhërave të prokurimit, urdhërave për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave për mbledhjen e të gjitha materjaleve të nevojshme që i bashkëlidhen dokumenteve të tenderit.
- Nis procedurat në mënyrë elektronike kur autorizohet nga njësi e prokurimit.
- Verifikon ligjshmërinë e ndjekjes së procedurave të tenderit gjatë zhvillimit të tij.
- Mban përgjegjësi për ruajtjen e fshehtësisë së përgatitjes së dokumentacionit dhe verifikimit të tij deri në komunikimin zyrtar, kandidatëve.
- U komunikon operatorëve ekonomikë që kanë tërhequr dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor çdo ndryshim në dokumentet e tenderit brënda afatit të parashikuar në ligj.
- Sqaron kandidatët që kanë tërhequr dokumentacionin për tender mbi çdo paqartësi apo ankesë që mund të kenë gjatë hartimit të ofertave në lidhje me dokumentacionin e vënë në dispozicion për çdo procedurë prokurimi:
- Relaton pranë përgjegjësit mbi ecurinë e procedurave, problemet e hasura gjatë zhvillimit të tyre, bën propozime konkrete për zgjidhjen e tyre duke respektuar legjislacionin në fuqi.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- Të plotësojë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si më poshtë:

- Te zoteroje diplome te nivelit “Master Shkencor” ne Shkencat Ekonomike.

- Te kete te pakten 3 vite eksperience pune ne kategorine ekzekutive .
- Të ketë njohuri bazë mbi punën.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese, koordinuese dhe të punës në grup.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorise se Burimeve Njerëzore të Bashkisë Finiq , dokumentat si më poshtë:

a-Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

b-Fotokopje të diplomës dhe liste notash e noterizuar (bashkalidhur dhe diploma bachelor)

c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f-Vetedeklarimin e gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore;

g-Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

h-Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

i-Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 04.05.2026.

Bashkia Finiq
Drejtoria e Burimeve Njerëzore
QENDRA E Bashkisë Finiq

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **06.05.2026**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Finiq do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në stenden e Bashkisë Finiq , listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele, si dhe datën ,vendin dhe oren e sakte ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Finiq , nëpërmjet adresës së e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 139, dt.17.12.2016 “Për vetqeverisjes vendore”.
- Njohuritë mbi Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar .

- Njohurite mbi Ligjin nr. 9131, dt. 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike” i ndryshuar.
- Njohurite mbi Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Njohuri mbi Ligji “Per Prokurime Publike”

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatet do te vleresohen per pervojen me 20 pike, 10 pike per trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushen , si dhe 10 pike per çertifikimet pozitive .Totali i pikeve per kete vleresim eshte 40 pike.

Totali i pikeve per kete vleresim eshte 40 pike.

Kandidatet gjate intervistes se strukturuar me goje do te vleresohen ne lidhje me :

- a- Njohurite , aftesite , kompetencen ne lidhje me pershkrimin e pozicionit te punes ;
- b- Eksperiencon e tyre te meparshme ;
- c- Motivimin , aspiratat dhe pritshmerine e tyre per karrierren .

Totali i pikeve per kete vleresim eshte 60 pike.

Ne perfundimin te vleresimit perzgjidhet kantidati, i cili renditet i pari nder kantidatet qe kane mare te pakten 70 pike.

Me shume detaje ne lidhje me vleresimin me pike, metodologjine e shperndarjes se pikeve, menyren e llogaritjes se rezultatit perfundimtar i gjeni ne Udhezimin nr. 2 dt. 27.03.2015 te Departamentit te Administrates Publike “www.dap.gov.al”

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Finiq do të shpallë fituesin në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen zyrtare të Bashkisë.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për shpalljen e fituesit.

2 PRANIMI NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL

Vetëm në rast se pozicioni renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës pranimit edhe për kandidatë nga jashtë shërbimit civil për kategorinë e ulët drejtuese, informacion që do ta merni në faqen zyrtare “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” duke filluar nga data **06.05.2026**.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NE SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë shërbimit civil të cilët plotësojnë kërkesat e nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 i ndryshuar .

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë :

- a) Te jete shtetas shqiptare;
- b) Te kete zotesi per te vepruar ;
- c) Te zoteroje gjuhen shqipe , te shkruar dhe te folur ;
- d) Te jete ne kushte shendetesore qe lejojne te kyeje detyren teknike perkatese;
- e) Te mos jete i denuar me vendim te formes se prere per te kryerjen e nje krimi apo per kryerjen e nje kundravajtje penale me dashje;
- f) Ndaj tij te mos jete mare masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil , qe nuk eshte shuar sipas ligjit 152/2013 “Per nepunesin civil “ i ndryshuar .

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si më poshtë:

- Te zoteroje diplome te nivelit “Master Shkencor” ne Shkencat Ekonomike”

Tjetër:

- Të ketë njohuri bazë mbi punën.
- Te kete experience pune.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese, koordinuese dhe të punës në grup.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a-Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjëni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

b-Fotokopje të diplomës dhe liste notash e noterizuar (përfshirë edhe diplomën bachelor);

c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d-Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

e-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

f-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

g-Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhet në Bashkinë Finiq .

Dokumentat e aplikimit duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 08.05.2026

në adresën

QENDRA E BASHKISE

FINIQ

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **18.05.2026**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Finiq do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, dhe në stenden e Bashkisë Finiq listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë e ulet drejtuese , si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Bashkia Finiq , për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuri mbi Ligjin nr.139 , date 17.12.2015 “Për veteqeverisjes vendore”.
- Njohuri mbi Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”indryshuar .
- Njohuri mbi Ligjin nr. 9131, dt. 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”i ndryshuar
- Njohuri mbi Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Njohuri mbi Ligji “Per Prokurime Publike”

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- deri në 40 pikë për vlerësimin me shkrim
- b- Intervisten e strukturuar me goje që konstiton ne motivimin , aspiratat dhe pritshmerine e tyre per karrieren , deri ne 40 pike.
- c- Jeteshkrimin , që konstiton ne vlerësimin e arsimimit te pervesjes e te trajnimeve , te lidhura me fushen, deri ne 20 pike.

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Finiq do të shpallë fituesin në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe stenden e Bashkise Finiq . Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e konkurimit, do të marrin informacion për fazat e mëtejshme të procedurës së konkurimit ne portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive “ si dhe ne stendat e Bashkise Finiq :

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme portalin e “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive “ duke filluar nga data 18.05.2026.